



VENDIM

Nr. 123 Datë. 01.12.2014

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “FATLUM” SH.P.K PER HEC “PERROLLAJ” SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE .

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “ll”; 9 dhe 39, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, gërma “P”; të Ligjit Nr. 138/2013 “Per Burimet e Energjive te Rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, gërma “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007,, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “FATLUM” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “FATLUM” sh.p.k për Hec-in “PERROLLAJ” me fuqi të instaluar totale 0,5 MW, si burim i rinovueshem energjie.

Konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “FATLUM” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregullores se Procedurave te Certifikimit te Prodhimit te Energjise Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**
Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “FATLUM” sh.p.k. për kualifikim impianti prodhues për Hec “Perrollaj”, si burim i rinovueshem energjie me fuqi të instalur 05 MW
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për:

VENDIMIN

Nr. 123 Datë. 01.12.2014

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES TË SHOQËRISË “FATLUM” SH.P.K PER HEC
“PERROLLAJ” SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE .**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
